Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut
Republic of North Macedonia

Ревизорско тело за ревизија на ИПА
Trupi i revizionit për revizion të IPA-s
Audit Authority for audit of IPA

Бр./Nr._____
Скопје/Shkup,_____20_____

PLANI STRATEGJIK I AUTORITETIT TË AUDITIMIT PËR AUDITIMIN E INSTRUMENTIT PËR NDIHMË PARA-ANËTARËSIMIT

2026 – 2030

Shkup, dhjetor 2025

Република Северна Македонија Republika e Maqedonisë së Veriut

AUTORITETI I AUDITIMIT
PËR AUDITIMIN E INSTRUMENTIT PËR NDIHMË PARA-ANËTARËSIMIT

Rr. 11 Tetori nr. 36,
1000 Shkup; Republika e Maqedonisë së Veriut
Telefon: ++389 (02) 3215-621;
Tel./Faks: ++389 (02) 3222-304
E-mail: ipa_aa@aaipa.gov.mk
Web: http://www.aaipa.gov.mk

Plani Strategjik i Autoritetit të Auditimit për periudhën 2026 - 2030 është miratuar nga Auditori Kryesor për IPA në muajin dhjetor 2025.

Autoriteti i Auditimit publikon këtë plan strategjik si udhërrëfyes për punën gjatë periudhës së përcaktuar.

Plani strategjik përmban pesë objektiva strategjike, të cilat janë ngushtësisht të lidhura me misionin e Autoritetit të Auditimit.

Gjatë realizimit të këtij Plani Strategjik, nëse lind nevoja për rishikimin e objektivave strategjike, ai do të përditësohet në pjesën e aktiviteteve, rezultateve të pritshme dhe afateve për zbatimin, në nivel vjetor.

PËRMBAJTJA ***faqe***

HYRJE – *3*
PARIMET BAZË NË PUNËN E AUTORITETIT TË AUDITIMIT – *12*
MISIONI – *12*
VIZIONI – *12*
OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE PRIORITETET – *12*
OBJEKTIVI STRATEGJIK 1 – *13*
OBJEKTIVI STRATEGJIK 2 – *13*
OBJEKTIVI STRATEGJIK 3 – *15*
OBJEKTIVI STRATEGJIK 4 – *16*
OBJEKTIVI STRATEGJIK 5 – *17*
ZBATIMI I OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE – *19*
NDJEKJA E REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE – *20*
FAKTORËT E RREZIKUT PËR ZBATIM TË SUKSESSHËM TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE – *20*
SIGURIMI I MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE- – *21*

Shtojcë

PLANI I VEPRIMIT i Autoritetit të Auditimit për realizimin e Objektivave Strategjike 2026-2030.....1-9

Shkurtesa të përdorura:

- **EK** – Komisioni Evropian
- **BE** – Bashkimi Evropian
- **IPA** – Instrumenti për Ndihmë Para-Anëtarësimit
- **Rregullorja për IPA** – Rregullorja për Zbatimin e IPA
- **NAO** – Koordinatori Nacional për Autorizim
- **Autoriteti i Auditimit** – Autoriteti i Auditimit për auditimin e Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA)
- **RMV** – Republika e Maqedonisë së Veriut

HYRJE

Përcaktimi strategjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut është anëtarësimi në bashkësinë e shteteve të Bashkimit Evropian, gjë që nënkupton se puna e Autoritetit të Auditimit për auditimin e Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA) (në tekstin e mëtejshëm: Autoriteti i Auditimit) duhet të harmonizohet plotësisht me mënyrën dhe rregullat e punës, si dhe me zbatimin e standardeve dhe praktikave më të mira të Bashkimit Evropian.

Me Vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në korrik 2007, Autoriteti i Auditimit u formua në kuadër të Entit Shtetëror të Auditimit, ndërsa nga qershori 2011 ushtron kompetencat e veta si subjekt juridik i pavarur, në përputhje me Ligjin për auditimin e Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA).

Instrumenti për Ndihmë Para-Anëtarësimit u krijua për herë të parë me miratimin e Rregullores (KE) nr.1085/2006 të Këshillit, më 17 korrik 2006, dhe i referohej periudhës programuese 2007-2013 (në tekstin e mëtejshëm: IPA I). Qëllimi i kësaj rregulloreje ishte të sigurohej ndihmë para-anëtarësimit për vendet përfituese, si mbështetje për zbatimin e reformave të nevojshme për të përmbushur kërkesat e Bashkësisë deri në anëtarësimin e tyre në Bashkimin Evropian.

Ndihma nga IPA I u zbatua përmes këtyre komponentëve:
I. Ndihmë për tranzicion dhe përmirësim institucional;
II. Bashkëpunim ndërkufitar;
III. Zhvillim rajonal;
IV. Zhvillim i burimeve njerëzore;
V. Zhvillim rural.

Për zbatimin e rregullores së sipërpërmendur, Komisioni i Bashkësive Evropiane më 12 qershor 2007 miratoi Rregulloren nr.718/2007[1]. Me këtë rregullore u vendosën rregullat e përbashkëta për zbatimin e ndihmës për të gjitha pesë komponentët e IPA I.

Më pas, u miratua kuadri ligjor që i referohet periudhës së dytë programuese të IPA, 2014-2020. Në gjysmën e parë të vitit 2014, u miratuan Rregullorja (BE) nr.231/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, më 11 mars 2014, për krijimin e Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA II), Rregullorja (BE) nr.236/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit më 11 mars 2014, për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të përbashkëta për zbatimin e instrumenteve të Unionit për financimin e veprimit të jashtëm (Rregullorja e Përbashkët për Zbatimin); Rregullorja (BE) nr.447/2014, më 2 maj

2014, për rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) nr.231/2014 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA II) (Rregullorja për Zbatimin e IPA II), me të cilat u përcaktuan rregullat për përdorimin e fondeve nga IPA II. Struktura administrative në Republikën e Maqedonisë së Veriut e akredituar për menaxhim të decentralizuar të fondeve nga IPA I vazhdoi të kryejë funksionet dhe kompetencat e saj në menaxhimin e fondeve nga IPA II gjatë periudhës programuese 2014–2020.

Ndihma nga IPA II programohet dhe zbatohet për zhvillimin e 8 sektorëve përmes pesë fushave (fusha e politikës 1-5):

1. Reformat për përgatitjen e anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe përmirësimi i institucioneve dhe kapaciteteve të lidhura me to
    - Sektori Demokraci dhe Qeverisje
    - Sundimi i Ligjit dhe të Drejtat Themelore
2. Zhvillimi socio-ekonomik dhe rajonal
    - Mjedisi Jetësor dhe Veprimet Klimatike
    - Transporti
3. Punësimi, politika sociale, arsimi, promovimi i barazisë gjinore dhe zhvillimi i burimeve njerëzore
    - Arsimi, Punësimi dhe Politikat Sociale
4. Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
    - Bujqësia dhe Zhvillimi Rural
5. Bashkëpunimi Rajonal dhe Territorial
    - Bashkëpunimi Rajonal dhe Territorial

Në përputhje me rregulloren për IPA II, nga qershori 2015, Marrëveshja Kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian, me të cilën rregullohen procedurat për zbatimin e ndihmës financiare nga Unioni për Republikën e Maqedonisë në kuadër të zbatimit të ndihmës sipas IPA II, si dhe Marrëveshja Sektoriale për zbatimin e ndihmës sipas IPARD II, Autoriteti i Auditimit kryen aktivitetet e mëposhtme:

a) Auditim për verifikimin e plotësisë, saktësisë dhe besueshmërisë së pasqyrave financiare vjetore ose ekstrakteve dhe llogarive përkatëse vjetore;
b) Auditim për verifikimin e funksionimit efikas dhe efektiv të sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes;
c) Auditim për verifikimin e ligjshmërisë dhe rregullsisë së transaksioneve të kryera;
ç) Përgatit strategji auditimi mbi bazë trevjeçare dhe i përditëson ato çdo vit;

d) Harton mendime vjetore auditimi për pasqyrat financiare vjetore ose ekstraktet dhe llogaritë përkatëse vjetore për vitin financiar paraprak, përmes verifikimit të plotësisë, saktësisë dhe besueshmërisë së tyre, për funksionimin e sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve të kryera, të mbështetura me raporte vjetore për aktivitetet e auditimit, ku paraqiten çdo mangësi e konstatuar në sistemet e menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes, si dhe çdo masë korrigjuese e ndërmarrë ose e planifikuar nga NAO, NF dhe/ose strukturat operative të përfshira;

dh) Harton mendim për çdo deklaratë përfundimtare financiare për shpenzimet që NAO ka paraqitur pranë Komisionit për mbylljen e çdo programi ose çdo pjese të tij. Kur është e përshtatshme, lëshon raport përfundimtar për aktivitetet e auditimit që mbështet mendimin.

Zbatimi i IPA II ende vazhdon, dhe për të ruajtur vazhdimësinë e zbatimit, është miratuar Rregullorja (BE) 2021/947 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, më 9 qershor 2021, për krijimin e Instrumentit për Fqinjësi, Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar – Evropa Globale; Rregullorja për krijimin e Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA III) e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për periudhën 2021-2027, nr.1529/2021, më 15 shtator 2021; si dhe Rregullorja e Komisionit (BE) nr.2021/2236, më 15 dhjetor 2021, për zbatimin e rregullave specifike për zbatimin e Rregullores (BE) 1529/2021 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për krijimin e Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA III), me të cilat janë përcaktuar rregullat për përdorimin e fondeve nga IPA III gjatë periudhës programuese 2021-2027. Gjithashtu, Marrëveshja Kornizë për Partneritet Financiar ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për procedurat specifike për zbatimin e ndihmës financiare nga Unioni për Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA III), është ratifikuar dhe publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr.235/2022.

Sipas rregulloreve të përmendura, ndihma nga IPA III do të zbatohet përmes pesë dritareve, të cilat përfshijnë programet përkatëse operative:

- Dritarja 1: Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia;
- Dritarja 2: Qeverisje e mirë, harmonizimi i legjislacionit, marrëdhënie të mira fqinjësore dhe komunikim strategjik;
- Dritarja 3: Agjenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme;
- Dritarja 4: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse
- Dritarja 5: Bashkëpunimi territorial dhe ndërkufitar.

Në përputhje me Rregulloren IPA 2021/1529 për krijimin e Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA III) dhe Marrëveshjen Kornizë për Partneritet Financiar ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për procedurat specifike për zbatimin e ndihmës financiare nga Unioni për Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA III), si dhe Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit Evropian për përcaktimin e dispozitave për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmës financiare të Unionit për Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas Programit për Zhvillim Rural të Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPARD III), Autoriteti i Auditimit do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

a) Auditim i plotësisë, saktësisë dhe vërtetësisë së pasqyrave financiare vjetore ose deklaratave dhe llogarive bazë vjetore;
b) Auditim i funksionimit efikas dhe efektiv të sistemeve të menaxhimit, kontrollit dhe mbikëqyrjes;
c) Auditim i ligjshmërisë dhe rregullsisë së shpenzimeve;
ç) Harton Strategjinë trevjeçare të auditimit;
d) Harton Mendimin Vjetor të Auditimit për vitin financiar paraprak, së bashku me Raportin Vjetor për aktivitetet e auditimit;
dh) Harton Mendim për çdo deklaratë përfundimtare financiare për shpenzimet që NAO ka paraqitur pranë Komisionit për mbylljen e çdo programi ose çdo pjese të tij. Kur është e përshtatshme, Raporti Përfundimtar i aktivitetit të auditimit mbështet mendimin;
e) Harton Raporte Përfundimtare të auditimit nga auditimet sistemike të kryera dhe i dorëzon pranë Komisionit.

Strategjitë trevjeçare të auditimit për zbatimin e IPA II dhe IPA III dorëzohen pranë DG NEAR – Drejtoratit të Përgjithshëm për Zgjerim dhe Fqinjësi Lindore, Drejtoratit të Përgjithshëm për Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe pranë NAO, ndërsa raportet dhe mendimet vjetore dorëzohen pranë drejtorateve përkatëse të Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kopje për NIPAC dhe NAO.

Korniza ligjore për auditimin e IPA dhe funksionimin e Autoritetit të Auditimit është përcaktuar me Marrëveshjen Kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian, me të cilën rregullohen procedurat për zbatimin e ndihmës financiare nga Unioni për Republikën e Maqedonisë në kuadër të zbatimit të ndihmës sipas IPA II, Marrëveshjen Kornizë për Partneritet Financiar ndërmjet Komisionit

Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për procedurat e veçanta për zbatimin e ndihmës financiare nga Unioni për Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA III), si dhe me Ligjin për Auditimin e IPA (Gazeta Zyrtare e RM nr. 66/10, 43/14, 154/15, 27/16, 190/16, 83/18 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 251/22 dhe 262/23).

Autoriteti i Auditimit, në përputhje me rregulloren e sipërpërmendur, funksionon si person juridik i pavarur dhe i veçantë, i cili është funksionalisht i pavarur nga të gjithë pjesëmarrësit në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të fondeve nga Instrumenti për Ndihmë Para-Anëtarësimit.

Ligji për Auditimin e IPA rregullon objektin e auditimit, organizimin dhe kompetencat e Autoritetit të Auditimit për auditimin e Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Njëkohësisht, me marrëveshjet kornizë dhe marrëveshjet sektoriale për IPARD, të lidhura ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian, përcaktohen funksioni, kompetencat dhe përgjegjësitë e Autoritetit të Auditimit në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit indirekt të ndihmës para-anëtarësimit të Bashkimit Evropian në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

[2]Marrëveshja Kornizë ndërmjet Republikës së Maqedonisë, e përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, dhe Komisionit Evropian për procedurat e zbatimit të ndihmës financiare nga Unioni për RM në kuadër të zbatimit të ndihmës sipas IPA II (Gazeta Zyrtare e RM nr. 99/15). Marrëveshja Kornizë për Partneritet Financiar ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, e përfaqësuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, për procedurat e veçanta për zbatimin e ndihmës financiare nga Unioni për Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPA III) (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 235/2022).
[3]Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit Evropian për vendosjen e dispozitave për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit për Republikën e Maqedonisë sipas IPA në fushën e politikave për "Bujqësi dhe Zhvillim Rural" (IPARD) (Gazeta Zyrtare e RM nr. 38/16). Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Komisionit Evropian për vendosjen e dispozitave për menaxhimin dhe zbatimin e ndihmës financiare të Bashkimit për Republikën e Maqedonisë së Veriut sipas Programit për Zhvillim Rural të Instrumentit për Ndihmë Para-Anëtarësimit (IPARD III).

Zhvillimi i mëtejshëm i Autoritetit të Auditimit do të realizohet në kushte të:

- procesit intensiv të afrimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut drejt Bashkimit Evropian përmes fillimit të negociatave për anëtarësim në Bashkim;
- proceseve intensive reformuese në të gjitha sferat e jetës ekonomike dhe politike; proceseve reformuese në administratën publike, veçanërisht në sistemin e kontrollit financiar dhe luftës kundër korrupsionit në shtet;
- aktiviteteve dhe proceseve intensive për bashkëpunim me institucione dhe organe vendore dhe ndërkombëtare.

Me anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO është realizuar një prioritet strategjik i rëndësishëm, i cili përbën një parakusht të sigurt për zbatimin e strategjive afatgjata për zhvillimin e mëtejshëm në të gjitha sferat e shoqërisë, duke përfshirë edhe objektivat dhe prioritetet strategjike për zhvillimin e mëtejshëm të punës së Autoritetit të Auditimit.

Autoriteti i Auditimit drejtohet nga Auditori Kryesor për IPA (AKIPA), i cili emërohet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me mandat 9-vjeçar. Auditori Kryesor për IPA ka një zëvendës (ZAKIPA) me mandat 9-vjeçar. Në strukturën organizative të Autoritetit të Auditimit ka tre këshilltarë të AKIPA dhe shtatë njësi organizative bazë – sektorë përmes të cilëve realizohen kompetencat, dhe ato janë: pesë Sektorë për auditim, Sektori për përmirësimin e auditimit dhe Sektori për çështje financiare dhe administrative-juridike. Aktualisht, në Autoritetin e Auditimit janë të punësuar 34 persona (nga të cilët 1 vend pune është pezull dhe dy persona janë me kontratë afatshkurtër) si dhe janë emëruar dy funksionarë (të gjithë me arsim të lartë). Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve, duke përfshirë edhe dy personat e emëruar:

- 19 janë auditorë shtetërorë të autorizuar
- 1 është auditor i brendshëm i autorizuar
- 2 kanë autorizim për auditim të brendshëm në sektorin publik
- 2 kanë certifikatë për hetues të mashtrimeve
- 2 kanë certifikatë ndërkombëtare për menaxhimin e rreziqeve nga korrupsioni
- 1 është doktor i shkencave ekonomike
- 14 janë magjistra në fushën përkatëse, që përbën një bazë solide për kryerjen kompetente të aktiviteteve të punës.

Autoriteti i Auditimit çdo vit i dorëzon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shqyrtim dhe informim Raportin Vjetor nga auditimi i pasqyrave financiare nga shoqëria e auditimit.

Punonjësit e Autoritetit të Auditimit janë të përfshirë në procesin e përmirësimit dhe aftësimit profesional të vazhdueshëm, si dhe në fitimin e përvojës për zbatimin e standardeve dhe rregulloreve ndërkombëtare të pranuara për auditim, si dhe arritjet më të fundit në praktikën e auditimit, në përputhje me standardet dhe kriteret e vendosura nga Bashkimi Evropian.
Në punën e tij, Autoriteti i Auditimit përdor përvojat, aftësitë dhe njohuritë e fituara nga puna e deritanishme, duke i përmirësuar dhe përshtatur ato me kërkesat specifike të Komisionit Evropian për auditimin e fondeve të përdorura nga IPA.

Për realizimin e aktiviteteve të auditimit, mjetet bazë që përdoren në Autoritetin e Auditimit janë:

- Manuali i auditimit i IPA-s**,** versioni 3, dhjetor 2018, i përbërë nga Pjesa e Përgjithshme, Pjesa e Veçantë për auditimin e IPA II, 2014-2020 për fushat e politikave 1, 2 dhe 3, dhe Pjesa e Veçantë për auditimin e IPARD II për fushën e politikës 4, si një mjet profesional në praktikën e auditimit;
- Manualet e auditimit për IPA III, versioni 1, mars 2023, të përbëra nga Pjesa e Veçantë I, Pjesa e Veçantë II për auditimin e Programeve nga IPA III dhe Pjesa e Veçantë III për auditimin e Programeve nga IPARD III, të cilat janë kyçe për përgatitjen e auditorëve për periudhën programore IPA III, 2021-2027.

Me qëllim përmirësimin e punës dhe bashkëpunimit në realizimin e kompetencave nga fusha e veprimtarisë së Autoritetit të Auditimit, si dhe shkëmbimin e përvojave, janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi me disa institucione në vend dhe rajon, dhe ato janë:

- Memorandum bashkëpunimi me Universitetin FON, Shkup në vitin 2019**,**
- Memorandum bashkëpunimi me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në shkurt 2021**,**
- Memorandum bashkëpunimi me Autoritetin e Auditimit të Republikës së Malit të Zi në korrik 2021**,**
- Memorandum bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës në gusht 2021**,**
- Memorandum bashkëpunimi me Autoritetin e Auditimit të Republikës së Shqipërisë në nëntor 2021**,**
- Në dhjetor 2021, Auditori Kryesor për IPA i Autoritetit të Auditimit për auditimin e IPA realizoi shkëmbim letrash bashkëpunimi me Drejtorin e

Përgjithshëm të Zyrës Evropiane për Luftën kundër Mashtrimeve (OLAF), me ç'rast u konfirmua gatishmëria për përmirësim të mëtejshëm të bashkëpunimit brenda mandateve përkatëse, për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së,

- Memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Financave në qershor 2023.

PARIMET BAZË NË PUNËN E AUTORITETIT TË AUDITIMIT

Pavarësia
Funksionalisht dhe operacionalisht i pavarur nga të gjithë pjesëmarrësit në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të IPA dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim, si kusht për realizimin efikas të kompetencave të Autoritetit të Auditimit;

Kompetenca
Përvetësimi i njohurive, përvojës, objektivitetit, integritetit dhe autoritetit gjatë shprehjes së mendimit të auditimit, konkluzioneve dhe rekomandimeve nga auditorët, duke kushtuar kujdes dhe vëmendje të duhur në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të pranuara për auditim;

Objektiviteti
Objektivitet në kryerjen e auditimit, ndershmëri dhe pa konflikt interesi, si dhe dhënia e mendimeve të bazuara ekskluzivisht në prova të siguruara dhe të formuara sipas standardeve ndërkombëtare të pranuara për auditim;

Neutraliteti
Ruajtja e vazhdueshme e pavarësisë së auditorëve nga ndikimet politike, duke kryer detyrat e auditimit në mënyrë të paanshme;

Racionaliteti
Kryerja e punëve të auditimit me shpenzim minimal të mjeteve financiare, që nënkupton përdorim ekonomik, efikas dhe efektiv të fondit të orëve të auditimit;

Konfidencialiteti
Të dhënat dhe informacionet e fituara gjatë auditimit ruhen nga auditorët si sekret tregtar dhe nuk lejohet prezantimi i tyre i paautorizuar tek persona të tjerë;

Profesionalizmi
Ndjekja e vazhdueshme e risive në fushën e auditimit, zbatimi i teknikave dhe mjeteve më të fundit dhe më të avancuara të auditimit, si dhe përmirësimi i vazhdueshëm i aftësive dhe shkathtësive të auditorëve;

Puna në ekip
Praktikimi i vazhdueshëm i bashkëpunimit kolegial, gjithëpërfshirës, konstruktiv dhe kreativ mes auditorëve, me respektim të plotë të individit, forcim të ndjenjës së përgjegjësisë, ndërgjegjësisë dhe profesionalizmit, si kusht për realizimin e vizionit, misionit dhe objektivave strategjike të Autoritetit të Auditimit.

PAVARËSI KOMPETENCË OBJEKTIVITET NEUTRALITET RACIONALITET KONFIDENCIALITET PROFESIONALIZËM PUNË NË EKIP

MISIONI

Autoriteti i Auditimit është një auditor i jashtëm i pavarur, kompetent për auditimin dhe dhënien e mendimit mbi funksionimin e duhur të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit të ndihmës para-anëtarësimit të BE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e pasqyrave financiare vjetore ose deklaratave dhe llogarive vjetore bazë, për ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve, me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të komunitetit dhe interesave nacionale.

VIZIONI

Përmirësimi i procesit të menaxhimit efikas dhe efektiv të fondeve nga IPA, i llogaridhënies dhe transparencës në përdorimin e tyre, përmes sigurimit të vazhdueshëm të integritetit dhe cilësisë në auditime, me qëllim dhënien e mendimeve dhe rekomandimeve të përshtatshme të auditimit për funksionim më efektiv dhe më të qëndrueshëm të sistemeve kompetente për menaxhim dhe kontroll të ndihmës para-anëtarësimit të BE-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut..

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE PRIORITETET

- ***Objektivi 1: Ruajtja e pavarësisë funksionale***
  Ruajtja e vazhdueshme e pavarësisë funksionale dhe operative të Autoritetit të Auditimit në kryerjen e auditimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, si dhe të aktiviteteve, transaksioneve dhe pasqyrave financiare ose deklaratave/llogarive vjetore, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim;

- ***Objektivi 2: Forcimi i kapaciteteve institucionale***
  Sigurimi i burimeve financiare, hapësinore, teknike dhe njerëzore të përshtatshme si parakusht për realizimin e kompetencave të Autoritetit të Auditimit;

- ***Objektivi 3: Sigurimi i cilësisë së auditimeve të kryera***
  Zhvillimi dhe përmirësimi i proceseve dhe procedurave për kryerjen e auditimeve në përputhje me rregulloret për zbatimin e IPA dhe standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim, si dhe ndjekja e efekteve nga auditimet e kryera;

- ***Objektivi 4: Zhvillimi i sistemit informativ dhe teknologjisë së informacionit***
  Zhvillimi i mëtejshëm dhe mirëmbajtja e sistemit informativ të Autoritetit të Auditimit, aplikimi i teknologjisë së informacionit dhe përdorimi racional dhe efikas i saj në auditim;

PAVARËSI KOMPETENCË OBJEKTIVITET NEUTRALITET RACIONALITET
KONFIDENCIALITET PROFESIONALIZËM PUNË NË EKIP

- ***Objektivi 5: Zhvillimi i sistemit të komunikimit***
  Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm përmes shkëmbimit të brendshëm të informacionit dhe komunikimit të jashtëm me strukturat IPA, me institucione dhe organe vendore dhe ndërkombëtare, si dhe informimi i publikut për punën e Autoritetit të Auditimit.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1

Ruajtja e pavarësisë funksionale

Ruajtja e vazhdueshme e pavarësisë funksionale dhe operative të Autoritetit të Auditimit në kryerjen e auditimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, si dhe të aktiviteteve, transaksioneve dhe pasqyrave financiare dhe deklaratave/llogarive vjetore, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim.

Objektivi i drejtpërdrejtë 1.1

Ruajtja e vazhdueshme e pavarësisë funksionale dhe operative të Autoritetit të Auditimit nga sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të fondeve nga IPA.

Aktivitete

Miratimi i Ligjit të ri për auditimin e programeve të financuara nga BE.

Objektivi i drejtpërdrejtë 1.2

Zhvillimi i mëtejshëm i pavarësisë funksionale dhe organizative të Autoritetit të Auditimit.

Aktivitete

- Ndryshime dhe plotësime / miratimi i akteve të reja të brendshme për organizimin e brendshëm dhe punën, si dhe sistematizimin e vendeve të punës në Autoritetin e Auditimit;
- Përditësimi i Analizës për ngarkesën e vendeve të punës (AVP);
- Përditësimi i Strategjisë për menaxhimin e burimeve njerëzore;
- Shpërndarja e përshtatshme e burimeve njerëzore brenda sektorëve dhe ekipeve të auditimit, si dhe caktimi i personave përgjegjës / drejtuesve të ekipeve të auditimit sipas kualifikimeve përkatëse dhe sipas nevojave të auditimeve dhe strategjive të auditimit.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 2

Forcimi i kapaciteteve institucionale

Sigurimi i burimeve financiare, hapësinore, teknike dhe njerëzore të përshtatshme si parakusht për realizimin e kompetencave të Autoritetit të Auditimit.

Objektivi i drejtpërdrejtë 2.1

Sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme për realizimin e kompetencave të Autoritetit të Auditimit dhe për forcimin e burimeve njerëzore.

Aktivitete

- Sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme për kushte hapësinore, materiale dhe teknike për punë;
- Sigurimi i hapësirës së vet të punës;
- Sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme me Buxhetin e Autoritetit të Auditimit për paga dhe avancimin e punonjësve ekzistues, si dhe për punësimin e stafit të ri të nevojshëm për realizimin e kompetencave të Autoritetit të Auditimit;
- Sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme me Buxhetin e Autoritetit të Auditimit për zbatimin e politikës për mbajtjen dhe motivimin e stafit profesional ekzistues;
- Sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme me Buxhetin e Autoritetit të Auditimit për pjesëmarrje në takime teknike dhe bilaterale me drejtoratet e përgjithshme kompetente;
- Sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme për trajnimin e punonjësve të Autoritetit të Auditimit me qëllim forcimin e kapaciteteve nga aspekti i rritjes së nivelit të kualifikimit përmes fitimit të aftësive dhe njohurive të reja;
- Sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme për kontrollin në vendngjarje të projekteve nga IPA.

Objektivi i drejtpërdrejtë 2.2

Zbatimi i zhvillimit profesional të vazhdueshëm të punonjësve në Autoritetin e Auditimit.

Aktivitete

- Planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm profesional dhe teknik të punonjësve në Autoritetin e Auditimit përmes zbatimit të Planit Vjetor të Trajnimeve (trajnime për punonjësit e sapopunësuar për përfshirjen e shpejtë në procesin e punës, trajnim për metodologjinë e auditimit, trajnime për verifikime në vend, përdorimin e udhëzimeve nga KE, trajnim për aplikimin e teknologjisë së informacionit në auditim dhe shkëmbim përvojash me autoritete auditimi nga vende të tjera, trajnime për harmonizimin e punës së Autoritetit me rregulloren për IPA III) dhe mundësi për praktikë në institucionet kompetente për auditim në vendet e BE-së dhe në Drejtoratet e Përgjithshme në Mbretërinë e Belgjikës, të cilat janë kompetente për vlerësimin e punës së Autoritetit të Auditimit.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 3

Sigurimi i cilësisë së auditimeve të kryera

Zhvillimi dhe përmirësimi i procedurave për kryerjen e auditimeve në përputhje me rregulloret për IPA dhe standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim, si dhe ndjekja e efekteve nga auditimet e kryera.

Objektivi i drejtpërdrejtë 3.1

Zbatimi i auditimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim, manualet e brendshme për auditimin e IPA-s të Autoritetit të Auditimit, si dhe udhëzimet dhe direktivat e marra nga drejtoratet e përgjegjshme të Komisionit Evropian, me qëllim përmirësimin e sistemit për sigurimin e cilësisë së auditimit.

Aktivitete

- Përgatitja e strategjive të auditimit në bazë trevjeçare sipas programeve dhe përditësimi i tyre çdo vit, në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim, udhëzimet dhe direktivat e marra nga Komisioni Evropian;
- Harmonizimi i planeve, programeve dhe listave të kontrollit për auditim me Marrëveshjet e lidhura për zbatimin e IPA-s, Udhëzimet e lëshuara nga Komisioni Evropian dhe kërkesat e drejtorateve kompetente të KE-së.

Objektivi i drejtpërdrejtë 3.2

Sigurimi i cilësisë së rezultateve nga kryerja e auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim.

Aktivitete

- Sigurimi i mbulimit të mjaftueshëm të proceseve, transaksioneve dhe aktiviteteve tek struktura kompetente objekt i auditimit, e cila ka të drejtën e menaxhimit të fondeve nga IPA, me qëllim dhënien e mendimit të auditimit për plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e pasqyrave financiare vjetore ose deklaratave/llogarive vjetore, funksionimin efikas dhe efektiv të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, si dhe ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve;
- Respektimi i udhëzimeve dhe procedurave për zbatimin e auditimeve dhe dhënia e konkluzioneve, gjetjeve dhe rekomandimeve cilësore dhe të qarta;
- Përmirësimi i kontrollit të cilësisë së punës së kryer të auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim dhe përmes zbatimit konsekuent të manualeve metodologjike dhe udhëzimeve;
- Planifikimi i duhur dhe shprehja e nevojës për përdorimin e punës nga një auditor tjetër ose ekspert, me qëllim sigurimin e mjeteve buxhetore në kohë, shpalljen e tenderit dhe lidhjen e kontratës.

Objektivi i drejtpërdrejtë 3.3

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e auditimit dhe ndryshimet në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit.

Aktivitete

- Planifikimi dhe zbatimi i procedurave në auditime për ndjekjen e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e kryera dhe masat e ndërmarra nga subjekti i auditimit për tejkalimin e dobësive dhe parregullsive të konstatuara (brenda auditimeve ose si realizim i një angazhimi të veçantë auditimi për ndjekjen e rekomandimeve);
- Monitorimi i ndryshimeve të ndodhura dhe identifikimi i rreziqeve në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit përgjegjës për zbatimin e IPA-s;
- Dorëzimi i Informacionit Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për raportet dhe mendimet vjetore me propozim-konkluzione për ndërmarrjen e masave dhe aktiviteteve për tejkalimin e dobësive dhe gjetjeve të konstatuara në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit përgjegjës për zbatimin e IPA.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 4

Zhvillimi i sistemit informativ dhe teknologjisë informatike

Zhvillimi i mëtejshëm dhe mirëmbajtja e sistemit informativ të Autoritetit të Auditimit, aplikimi i teknologjisë së informacionit dhe përdorimi racional dhe efikas i saj në auditim

Objektivi i drejtpërdrejtë 4.1

Zbatimi dhe mirëmbajtja e sistemit informativ të Autoritetit të Auditimit, përdorimi racional dhe efikas i pajisjeve të teknologjisë së informacionit.

Aktivitete

- Monitorimi i realizimit të planit të veprimit nga strategjia për IT dhe përditësimi i saj;
- Zbatimi i standardeve të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit;
- Ndjekja e trendeve në fushën e pajisjeve informatike dhe blerja e harduerit dhe softuerit sipas nevojave të Autoritetit të Auditimit;
- Mirëmbajtja dhe përdorimi i softuerit të auditimit për zgjedhjen statistikore të mostrës dhe softuerit për punën zyrtare e-Arkiva;
- Blerja e softuerit të auditimit përmes një projekti të mbështetur nga Delegacioni i Bashkimit Evropian;
- Aksesimi i Platformës Nacionale për Interoperabilitet dhe mundësia e përdorimit të saj;
- Blerja e një serveri rezervë për lokacionin në Prilep të Autoritetit të Auditimit (Qendra për Rimëkëmbje nga Fatkeqësitë), i cili do të funksionojë në nivel shtetëror;
- Blerja e shërbimit për virtualizimin e mjedisit të serverit dhe për migrimin nga serverët fizikë në serverë virtualë në Autoritetin e Auditimit.

OBJEKTIVI STRATEGJIK 5

Zhvillimi i sistemit të komunikimit

Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit për komunikim të brendshëm dhe të jashtëm përmes shkëmbimit të brendshëm të informacionit dhe komunikimit të jashtëm me strukturat IPA, me institucione dhe organe vendore dhe ndërkombëtare, si dhe informimi i publikut për punën e Autoritetit të Auditimit.

Objektivi i drejtpërdrejtë 5.1

Zhvillimi i mëtejshëm dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mënyrës, metodave dhe përdorimit të praktikave më të mira në komunikim dhe informim të drejtorateve të përgjegjshme të Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe strukturave kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin indirekt të IPA, në përputhje me marrëveshjet kornizë, sektorale, financiare dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.

Aktivitete

- Përgatitja, përditësimi dhe dorëzimi në kohë i strategjive të auditimit;
- Përgatitja dhe dorëzimi i Mendimit të Auditimit dhe raportit të auditimit për saktësinë dhe plotësinë e pasqyrave financiare të lëshuara nga NAO, që lidhen me ndryshimet në librin e debitorëve dhe menaxhimin e borxhit për fushën e politikës 4 – Bujqësi dhe Zhvillim Rural, drejtuar Komisionit Evropian;
- Përgatitja dhe dorëzimi në kohë i raporteve përfundimtare individuale nga auditimet sistemike të kryera, në përputhje me IPA III, drejtuar drejtorateve kompetente të Komisionit Evropian;
- Përgatitja dhe dorëzimi në kohë i mendimeve vjetore të auditimit dhe raporteve vjetore për aktivitetet e auditimit drejtuar drejtorateve kompetente të Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (për IPA II dhe IPA III);
- Përgatitja dhe dorëzimi i Mendimit për çdo deklaratë financiare përfundimtare për shpenzimet që NAO ka paraqitur Komisionit për mbylljen e çdo programi ose pjese të tij dhe, kur është e përshtatshme, përgatitja dhe dorëzimi i raportit përfundimtar të aktivitetit të auditimit që mbështet mendimin, drejtuar drejtorateve kompetente të Komisionit Evropian;
- Përgatitja dhe dorëzimi i draftit dhe raporteve përfundimtare nga auditimet sistemike, auditimet e operacioneve dhe auditimet e llogarive drejtuar strukturave kompetente për menaxhimin e IPA-s në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Përgatitja dhe dorëzimi i rezultateve nga auditimet e kryera nga anëtarët e Grupit të Auditorëve për programet e bashkëpunimit ndërkufitar, objekt i auditimit, drejtuar autoriteteve kompetente të auditimit;
- Përgatitja dhe dorëzimi i mendimeve të tjera të auditimit dhe raporteve të auditimit sipas kërkesës së drejtorateve kompetente;
- Informimi për realizimin e strategjive të auditimit para komiteteve përkatëse të monitorimit për zbatimin e fondeve nga IPA;

- Kryerja e auditimeve me kërkesë direkte nga DG NEAR, DG AGRI ose drejtorate të tjera të Komisionit Evropian (auditime për pajtueshmërinë e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit në Republikën e Maqedonisë së Veriut me fondet nga IPA III për periudhën programore 2021-2027).

Objektivi i drejtpërdrejtë 5.2

Shkëmbimi i informacionit, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe informimi i publikut për punën e Autoritetit të Auditimit.

Aktivitete

- Përditësimi i vazhdueshëm i UEB faqes të Autoritetit të Auditimit;
- Sigurimi i linjës kombëtare private Ethernet (nEPL) për lidhjen e rezervës (back up) në lokacionin e Autoritetit në Prilep (Qendra për Rimëkëmbje nga Fatkeqësitë), e cila do të funksionojë në nivel shtetëror;
- Organizimi i takimeve të punës me përfaqësues nga drejtoratet kompetente, nga vendet anëtare dhe vendet kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, për shkëmbim mendimesh mbi çështjet e hapura, fitimin e përvojës, njohurive dhe praktikave më të mira;
- Nënshkrimi i memorandumeve të bashkëpunimit me institucione relevante në vend dhe jashtë, me qëllim përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit në punën e Autoritetit të Auditimit.

Sipas objektivave dhe prioriteteve të përcaktuara, Autoriteti i Auditimit për auditimin e IPA për periudhën 2026-2030 do të realizojë:

- Zbatimin e kompetencave të përcaktuara me Ligjin për auditimin e IPA-s;
- Zbatimin e auditimeve të planifikuara të përcaktuara me strategjitë trevjeçare të auditimit, si dhe zhvillimin dhe përmirësimin e akteve metodologjike dhe manualeve për kryerjen e auditimeve në përputhje me rregulloret për IPA dhe standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim, si dhe ndjekjen e efekteve nga auditimet e kryera.
- Përmirësimi i procesit të menaxhimit efikas dhe efektiv të fondeve nga IPA, i llogaridhënies dhe transparencës në përdorimin e tyre, përmes sigurimit të vazhdueshëm të integritetit dhe cilësisë në auditime, me qëllim dhënien e mendimeve dhe rekomandimeve të auditimit për funksionim më efektiv dhe më të qëndrueshëm të sistemeve kompetente për menaxhim dhe kontroll të ndihmës para-anëtarësimit të BE-së me Republikën e Maqedonisë së Veriut;

- Kryerja pa pengesa e kompetencave të caktuara përmes sigurimit të hapësirës dhe pajisjes teknike të përshtatshme për punë;
- Pjesëmarrje aktive në parandalimin e korrupsionit, e cila realizohet përmes zbatimit të standardeve ndërkombëtare për auditim të jashtëm dhe në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në nivel shtetëror që mbulojnë fushën e parandalimit dhe luftës kundër korrupsionit;
- Aftësimi parandalues dhe forcimi i kapaciteteve institucionale për luftë efikase kundër korrupsionit dhe përpjekja për zhvillimin dhe zbatimin e mekanizmave efikasë dhe funksionalë për uljen e rreziqeve nga korrupsioni, identifikimin e shkaqeve, kushteve dhe faktorëve;
- Sigurimi i vazhdueshëm i cilësisë në punë përmes forcimit të kapaciteteve me rritjen e nivelit të kualifikimit dhe zhvillimit profesional, si dhe miratimit të politikave të përshtatshme për mbajtjen dhe motivimin e punonjësve.

ZBATIMI I OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Gjatë realizimit të këtij plani strategjik, nëse lind nevoja për rishikimin e objektivave strategjike, ai do të përditësohet në pjesën e aktiviteteve, rezultateve të pritshme dhe afateve për zbatimin, në bazë vjetore.
Për zbatimin e kompetencave ligjore, përmes realizimit të objektivave strategjike, Autoriteti i Auditimit do të vazhdojë të forcojë kapacitetet dhe të sigurojë një nivel të lartë kompetence dhe efektiviteti gjatë kryerjes së auditimeve, në përputhje me rregullat dhe dispozitat e Bashkimit Evropian dhe standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim (ISSAI).

NDJEKJA E REALIZIMIT TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Monitorimi i realizimit të aktiviteteve të planifikuara, rezultateve të pritshme dhe afateve të përcaktuara në Planin e Veprimit për realizimin e objektivave strategjike të Autoritetit të Auditimit kryhet vazhdimisht nga drejtuesit e Autoritetit të Auditimit. Realizimi i objektivave strategjike monitorohet përmes indikatorëve të përcaktuar, përmes të cilëve matet shkalla e realizimit të objektivave të parashikuara në nivel afatshkurtër dhe afatmesëm.

FAKTORËT E RREZIKUT PËR ZBATIM TË SUKSESSHËM TË OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Zbatimi i objektivave strategjike është i kushtëzuar nga:

- forcimi i pavarësisë, rolit dhe pozicionit të Autoritetit të Auditimit në sistemin indirekt të menaxhimit dhe kontrollit të fondeve të alokuara nga IPA;
- sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme për realizimin dhe zbatimin e objektivave strategjike përmes buxheteve vjetore të Autoritetit të Auditimit;
- krijimi i kushteve për mbajtjen dhe motivimin e punonjësve në Autoritetin e Auditimit.

SIGURIMI I MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE STRATEGJIKE

Tabela: Mjetet e duhura financiare për realizimin e bjektivave strategjike

Objektiva të drejtpërdrejta	2026	2027	2028	2029	2030
1	2	3	4		
1.1 Ruajtja e vazhdueshme e pavarësisë funksionale dhe operative të Autoritetit të Auditimit nga sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të fondeve nga IPA; 1.2 Zhvillimi i mëtejshëm i pavarësisë funksionale dhe organizative të Autoritetit të Auditimit; 2.1 Sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme për realizimin e kompetencave të Autoritetit të Auditimit; 3.2 Sigurimi i cilësisë së rezultateve nga kryerja e auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim; 3.3 Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e auditimit dhe ndryshimet në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit; 4.1 Zbatimi dhe mirëmbajtja e sistemit informativ të Autoritetit të Auditimit, përdorimi racional dhe efikas i pajisjeve të teknologjisë së informacionit; 5.1 Zhvillimi i mëtejshëm dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mënyrës, metodave dhe përdorimit të praktikave më të mira në komunikim dhe informim të drejtorateve kompetente të Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe strukturave kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin indirekt të IPA, në përputhje me marrëveshjet kornizë, sektorale, financiare dhe rregulloret e Bashkimit Evropian; 5.2 Shkëmbimi i informacionit, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe informimi i publikut për punën e Autoritetit të Auditimit.	40 – Paga dhe kompensime 44.053.000 mkd	40 – Paga dhe kompensime 52.555.000 mkd	40 – Paga dhe kompensime 52.555.000 mkd	40 – Paga dhe kompensime 52.555.000 mkd	40 – Paga dhe kompensime 52.555.000 mkd
2.1 Sigurimi i mjeteve financiare të nevojshme për realizimin e kompetencave të Autoritetit të Auditimit 2.2 Zbatimi i zhvillimit profesional të vazhdueshëm të punonjësve në Autoritetin e Auditimit; 3.1 Zbatimi i auditimeve në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim, manualet e brendshme për auditimin e IPA të Autoritetit të Auditimit, si dhe udhëzimet dhe direktivat e marra nga	42 – Mallra dhe shërbime 8.866.000 mkd	42 – Mallra dhe shërbime 15.696.000 mkd	42 – Mallra dhe shërbime 15.697.000 mkd	42 – Mallra dhe shërbime 15.851.000 mkd	42 – Mallra dhe shërbime 15.798.000 mkd

drejtoratet kompetente të Komisionit Evropian, me qëllim përmirësimin e sistemit për sigurimin e cilësisë së auditimit; 3.2 Sigurimi i cilësisë së rezultateve nga kryerja e auditimit në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuara për auditim; 3.3 Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e auditimit dhe ndryshimet në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit; 4.1 Zbatimi dhe mirëmbajtja e sistemit informativ të Autoritetit të Auditimit, përdorimi racional dhe efikas i pajisjeve të teknologjisë së informacionit; 5.1 Zhvillimi i mëtejshëm dhe përmirësimi i vazhdueshëm i mënyrës, metodave dhe përdorimit të praktikave më të mira në komunikim dhe informim të drejtorateve kompetente të Komisionit Evropian dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe strukturave kompetente në Republikën e Maqedonisë së Veriut përgjegjëse për menaxhimin dhe kontrollin indirekt të IPA, në përputhje me marrëveshjet kornizë, sektorale, financiare dhe rregulloret e Bashkimit Evropian; 5.2 Shkëmbimi i informacionit, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe informimi i publikut për punën e Autoritetit të Auditimit.					
4.1 Zbatimi dhe mirëmbajtja e sistemit informativ të Autoritetit të Auditimit, përdorimi racional dhe efikas i pajisjeve të teknologjisë së informacionit.	48 – Shpenzime kapitale 631.000 mkd	48 – Shpenzime kapitale 860.000 mkd	48 –Shpenzime kapitale 1.220.000 mkd	48 –Shpenzime kapitale 826.000 mkd	48 –Shpenzime kapitale 530.000 mkd

Revizor Kryesor për IPA,

Mr. Milaim Abduraimi, CIA, CIAPS

Përpunoi: mr. Sonja C.simeonova, RASH
Kontrolloi: mr. Vesna Mladenovska, RASH